

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Hapësirat e pashfrytëzuara në shërbim të komunitetit, Bashkia e Tiranës i kthen në kënde lojërash dhe mjedise çlodhjeje - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/hapesirat-e-pashfrytezuara-ne-sherbim-te-komunitetit-bashkia-e-tiranes-i-kthen-ne-kende-lojërash-dhe-mjedise-c'lodhjeje/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:16:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	12 shtator 2026, 18:24:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	85c5a684f49248abf4f5824ef2c9905d146f8f49b99b944c3c027ccafb7e1f8d
TEKSTI	3e01b6cca4a655b33ac1a08f8a6e3f7580dda8b91086ec91f28cf684c3da5f73
PAMJA	53bebd52ffab408f9c434ca28cccb594cca90d15e4e2f3ff9bf79b0f8bad63ea

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	6e039971404eb7e64691197cd6b74bd54d8bfaf57c967d0e5a57ae24a4473532
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	189cdded276785f170fe9cc7ce5e87625aab0e70d3bc68c5e8e7b4173c15ebbc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/6e039971404eb7e64691197cd6b74bd54d8bfaf57c967d0e5a57ae24a4473532>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Hapësirat e pashfrytëzuara në shërbim të komunitetit, Bashkia e Tiranës i kthen në kënde lojërash dhe mjedise çlodhjeje

LAJMET E FUNDIT

Demo

Hapësirat e pashfrytëzuara në shërbim të komunitetit, Bashkia e Tiranës i kthen në kënde lojërash dhe mjedise çlodhjeje

SEPTEMBER 12, 2026



Deri pak ditë më parë, zona pas shkollës 9-vjeçare Vasil Shanto në njësinë administrative nr.5 në Tiranë ka qenë e mbuluar nga shkurret. Por banorët janë organizuar dhe i janë drejtuar me një kërkesë zyrtare njësisë administrative për ta transformuar.

Gjithçka tashmë është pastruar dhe kjo hapësirë pritet të kthehet në një kënd lojërash dhe stola pushimi.

“Tani është për një pjesë që ne për ne ka më tepër rëndësi për fëmijët. Kështu që shpresojmë që të jetë një investim jo i domosdoshëm, por shumë frytdhënës edhe për hapësirën që do t’ju ofrohet banorëve të moshave të tjera, por kryesisht për fëmijët. Me kërkesën e banorëve është bashkarisht them është realizuar një ide shumë e mirë. Në tërë këtë zonë nuk ka asnjë kënd lojërash. Për më tepër kaq të organizuar”, tha një qytetar.

“Kam mendim të bëhen sa më shumë investime edhe rrofshin që po i bëni, mendoni dhe për moshat tona dhe për fëmijët. Jo, këtu s’ka të lagajaja jonë. Edhe ishte e domosdoshme. Është patjetër. Ishalla të bëhet dhe të mbahet”, tha një tjetër qytetar.

Njësoj si në këtë rast, edhe banorë të zonave të tjera të kryeqytetit mund t’i drejtohen njësisë administrative dhe të kërkojnë transformimin e tyre në hapësira të dobishme për komunitetin.

Sipas Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, aktualisht po punohet në 3 njësi, pas kërkesave të vetë banorëve.

“Është njësi nr. 5 këtu ku jemi. Po punohet njëkohësisht në njësinë numër 3 dhe në njësinë numër 7. Edhe atje në bazë të kërkesës që kanë bërë banorët e zonave janë administruar kërkesat tek njësitë administrative dhe ato na kanë përcjellë ne”, tha Albi Lushi, shefi i projektimit dhe supervizimit teknik ne APR.

Megjithatë, jo çdo hapësirë mund të transformohet.

“Është shumë e rëndësishme që të jetë statusi i tokës të shtetit dhe në bazë të kësaj pastaj ne marrim të gjithë procedurat e nevojshme për të ndërhyrë dhe për të për të transformuar hapësirën në të cilën kërkohet bëhet kërkesa”, tha Albi Lushi, shefi i projektimit dhe supervizimit teknik ne APR.

Ndërkohë, Bashkia e Tiranës ka një tjetër shërbim për qytetarët. Mobilet e vjetëruara të shtëpisë nuk duhet të përfundojnë në koshat e zakonshëm të mbetjeve. Qytetarët që duan t’i largojnë nga banesa, mund të kontaktojnë në numrin e publikuar nga bashkia. Më pas, punonjësit e shërbimit shkojnë në banesë dhe i marrin, duke shmangur hedhjen e tyre në hapësirat publike.

Postimet e reja

Zjarri në Valare të Gjirokastrës, flakët...

SEPTEMBER 13, 2026

Rama reagon ndaj gjyqtarit të GJKKO: E...

SEPTEMBER 13, 2026

Droni rus godet trenin në Ukrainë, pak minuta më...

SEPTEMBER 13, 2026

Trump paralajmëron Zelenskyn: Ndaloni sulm...

SEPTEMBER 13, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 8, 2026

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit ka bërë thirrje për konsumatorët që kanë blerë një produkt sallami...

6 milionë euro të Startup Albania: Përfutuesit, qokat dhe “problematikët”

Beralb fitoi 15 mln euro nga bakri shqiptar, por po helmon fshatra të tërë me ndotje

LISTAT E DELINËS/ Granti për startup-et riciklon futuesit, 15 emra morën para edhe në vitin 2025

Na ndiq

Facebook

Instagram

YouTube

TikTok

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu